









## Hapja e thirrjes për aplikime për programin Trajnimi i Trajnerëve

 Projekti EU 4 Inclusive Teaching hap thirrjen për pjesëmarrje në programin e Trajnimit të Trajnerëve për   mësuesit e rinj, Drejtuesit e rrjeteve profesionale, Drejtorët dhe Zëvendës Drejtorët e shkollave publike të arsimit para-universitar. Projekti synon të trajnojë 320 pjesëmarrës të motivuar mbi mësimdhënien gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në kompetenca. Trajnimi do të kryhet nga trajnerë finlandezë nën udhëheqjen e Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Tampere, i cili është një institucion i specializuar  në zhvillimin profesional të mësuesve me bazë në FI Finlandë dhe eksperiencë ndërkombëtare. Në kuadër të projektit, 320 pjesëmarrësit do të përgatiten për të trajnuar 15,000 mësues në të gjithë vendin.

 Me hapjen e kësaj thirrje, projekti EU 4 Inclusive Teaching ka hyrë në fazën më dinamike të zbatimit të tij, pas muajsh të tërë përgatitje. Programi i trajnimit i cili do të akreditohet nga ASCAP, është ndërtuar mbi përfundimet e një raporti rishikimi të  kurrikulave të zhvillimit profesional për mësuesit në detyrë për sa i përket mësimdhënies gjithëpërfshirëse të bazuar në kompetenca.

 Për të lexuar më shumë rreth programit ndiqni lidhjen <http://bit.ly/3uOdzav>

 Për t'u bërë pjesë e programit të Trajnimit të Trajnerëve, ju duhet të plotësoni formularin e aplikimit në këtë [lidhje](#).

 Projekti EU 4 Inclusive Teaching financohet nga Bashkimi Evropian, dhe zbatohet nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara i Tampere.

#InclusiveAlbania

#EU4InclusiveTeaching